



Në mbështetje të Nenit 12, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për parandalimin e korrupsionit (*Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022*), si dhe në kuptim të zbatimit të dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave (*Gazeta Zyrtare nr. 21, datë 10.08.2022*) Nenit 11 dhe Nenit 34 paragrafi 3, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 01.03.2023, nxjerr:

## V E N D I M

### Për miratimin e Sistemit Elektronik të Deklarimit të Pasurisë

1. Miratohet Sistemi Elektronik për Deklarimin e Pasurisë nga Subjektet Deklaruese (DMSA).
2. Obligohet Njësia përgjegjëse për Teknologji Informative dhe Departamenti për Parandalimin e Korrupsionit, për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve për vënien në funksion të DMSA.
3. Për zbatimin e këtij në raport me subjektet deklaruese obligohet Departamenti për Parandalimin e Korrupsionit.
4. Vendimi hyn në fuqi datën e nënshkrimit.

### A r s y e t i m

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka miratuar Sistemin Elektronik të Deklarimit të Pasurisë sipas pikës 1 të dispozitivit të këtij Vendimi. Njësitë përkatëse të theksuara si në pikën 2 të dispozitivit të këtij Vendimi janë të obliguara për vënien në funksion dhe mbarëvajtjen e sistemit elektronik të deklarimit të pasurisë.

Nga ajo çfarë u theksua në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Yll BULESHKAJ

Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit

Vendimi i dërgohet:

- Departamentit për Parandalimin e Korrupsionit;
- Administratorit të Lartë të TI-së për sisteme
- Zyrës së Drejtorit;
- Arkivit;